



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	04/03/2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Abdulsatar IBRAHIMI Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Kostt- Sh.a.
CC:	z. Mustafë HASANI Kryeshf Ekzekutiv i Kostt - Sh.a.
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Furnizim me aksesore të TI "



I nderuar z. Ibrahim,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin lidhur me Tenderin "Furnizim me aksesore të TI " me numër prokurimi: KOSTT 5320/18 16 11 121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Furnizim me aksesore të TI " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

A r s y e t i m

Operatori i Sistemin, Transmisioni dhe Tregu sha., si Autoritet Kontraktues ka përgatit Njoftimin për Kontratë me titull: "Furnizim me aksesore të TI " me numër prokurimi: KOSTT 5320/18 16 11 121. Ky aktivitet i prokurimit më datë 18/02/2016 është publikuar në web faqen e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik. Agjencia kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë ekzaminimit të aktivitetit të prokurimit nga Dosja Tenderit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në njoftimin për kontratë I cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 18.02.2016 për aktivitetin e prokurimit publik me titull: **Furnizim me aksesore të TI, tek rubrika III.2.4** Kapaciteti teknik dhe profesional pika 1. **Keni kërkuar: 2(dy) dëshmi mbi realizimin e projekteve të ngjashme, dëshmia e kërkuar: Ofertuesi duhet ti prezantoj së paku dy(2) referenca për furnizime me aksesore të TI nga viti 2013, kërkesë kjo e cila konsiderojmë se bie ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik. Formulimi i tillë i kërkesës nga ana e Autoritetit Kontraktues lë hapësirë që të pranohen kontrata dhe referenca edhe për vitin 2016.**

Bazuar në legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, një Autoritet Kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkoj si dëshmi kontrata dhe referenca me të cilat do ta vërtetonte kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse e vendos një kërkesë të tillë, për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të OE-ve, atëherë detyrimisht këto kontrata dhe referenca duhet ti kërkoj në tri vitet e fundit (2013,2014 dhe 2015).

Gjatë shfletimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit Agjencia kë vërejtur se tek pjesa e Specifikimeve Teknike për furnizim me aksesore të TI në pozicionin me nr.15, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar TV camera **Samsung VG-STC5000/ZA**.

Sipas legjislacionet në fuqi për Prokurim Publik me përcaktimin e emrit të prodhuesit të këtyre mallrave, mund të favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër. Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund ti referohet një standardi vendor, European ose ndërkombëtar, por nuk lejohet assesit të kërkohej emërtimi i të këtyre mallrave.

Njësia kërkuese pranë Autoritetit kontraktues duhet të ketë kujdes që me rastin e formulimit të specifikimeve teknike të mos formuloj specifikime favorizuese për prodhues të caktuar e në të njëjtën kohë ti diskriminoj Operatorët tjerë ekonomik.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 28 Specifikimet teknike dhe nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

05 * 0105